

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Emine Kaçiku anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A.S. dhe V. S., me vendbanim në Pejë, të përfaqësuar nga Avokatura N., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, CA.nr.1480/2014 datë 10.1.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21 prill 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, CA.nr.1480/2014 datë 10.1.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.958/2012 datë 14.2.2014, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, dhe e paditura është detyruar që në emër të kompensimit të dëmit jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 31.8.2012, paditësit A. S., t’i paguajë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.000 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 2.400 €, dhe në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1.000 €, ndërsa për tej pjesës së gjykuar kërkesëpadia e paditësit refuzohet si e pabazuar. E paditura është obliguar që paditësit V. S., në emër të dëmtimit të motoçikletës në aksidentin e lartpërmendur t’i paguajë kompensimin prej 221,40 €. E paditura obligohet që shumat e lartpërmendura paditësve t’iu paguajë me kamatë prej 4,5% nga data 5.2.2014 e gjer në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.675 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm. Kërkesëpadia e paditësve për pagesën e kamatës prej 12% është refuzuar si e pabazuar.

Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pjesërisht është miratuar si e bazuar ankesa e të paditurës, dhe është ndryshuar pjesa e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kamatën e gjykuar ashtu që në shumat e gjykuara paditësve iu është pranuar kamata si për mjetet e deponuara në kursim në bankat vendore me afat prej 1 viti dhe pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 14.2.2014, si ditë e dhënies së aktgjykimit e deri në pagesën definitive. Ankesa e të paditurës përkitazi pjesën aprovuese të kërkesëpadsisë. është refuzuar si e pabazuar, kështu që në këtë pjesë i njëjti aktgjykim është vërtetuar. Përkitazi me pjesën refuzuese të kërkesë padsisë i njëjti aktgjykim ka mbetur i pashqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të pranohet si i bazuar, dhe të dy aktgjykimet e lartpërmendura të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 31.8.2012, rreth orës 11:30, në Pejë, në Rr. "...", përballë firmës "E.", papritmas nga krahu i majtë furishëm ndërpret rrugën drejtuesi i automjetit "N." i siguruar tek e paditura, i cili para se të ndërmerr këtë veprim ishte i parkuar në trotuar përballë firmës "E.", duke mos u siguruar se në këtë rrugë nga krahu i djathtë ishte duke qarkulluar paditësi A. S. me motoçikletë, i cili me të arritur në vendin e cekur, në pamundësi për t'iu shmangur aksidentit me pjesën e parë ballore të motoçikletës godet automjetin "N." në pjesën e parë të anës së djathtë me ç'rast paditësi pëson lëndime trupore, dhe dëmtim të motoçikletës. Sipas ekspertëve mjekësor Dr. I. K., ortoped-traumatolog dhe Dr. M. H., neuropsikiatër, të cilët në prezencën e të autorizuarit të paditurës janë dëgjuar në seancën e datës 3.12.2012, rezulton se paditësi A. S., në këtë aksident kë pësuar lëndim të natyrës së rëndë, thyerje të gashtrës së gjurit të djathtë, dhe gërvishtje sipërfaqësore të këtij gjuri, dhe si pasojë e këtij lëndimi paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë me intensitet dhe kohëzgjatje të ndryshme si dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në lartësi

prej 5%, i cili, duke marrë parasysh moshën e paditësit, manifestohet në dhimbje të gjurit të djathtë i shprehur më tepër në ngarkesa fizike siç janë ngritje dhe zbritje në lartësi, aktivitete sportive si dhe punët e përditshme të cilat kërkojnë kryerjen e aktivitetit në pozitë të ulur, si dhe në ndërrimin e kushteve atmosferike, përndryshe lëvizshmëria e gjurit të djathtë është e ruajtur në masën 95%. Në bazë të ekspertizës së makinerisë të Ing.i Dipl.A. Z. rezulton se vlera riparuese e motoçikletës është 221,40 €. Është jo kontestues fakti se e paditura në procedurën jashtë gjyqësore paditësve u ka ofruar kompensimin prej 2.100 € për të gjitha kategoritë kompensuese.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësioj gjykata e shkallës së parë ka gjetur se e paditura është përgjegjës për kompensimin e dëmit të paditësve, nga baza e sigurimit të detyrueshëm nga përgjegjësia në komunikacion, se baza ligjore e kërkesëpadisë është jo kontestuese, ndërsa lartësinë e dëmshpërblimit e ka caktuar në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertëve mjekësor të lartpërmendur, e duke u bazuar në kriteret ligjore të parapara me nenin 200 të LMD. Ndaj paditësit V. S., për dëmtim të motoçikletës, lartësia e kompensimit është caktuar në bazë të vlerësimit të ekspertit të makinerisë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës sa i përket lartësisë dhe bazës ligjore për caktimin e një dëmshpërblimi të tillë, e në të cilin drejtim ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, mirëpo sa i përket vendimit për kamatën e aprovuar, ka ndryshuar të njëjtin aktgjykim duke iu pranuar paditësve në shumën e gjykuar kamatën e cila paguhet si për mjetet e deponuara në kursim në afat mbi 1 vit e pa destinim të përcaktuar. Gjykata e shkallës së dytë me këtë rast, ka pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së parë.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me pranimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësve, pasi që këto aktgjykime nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Së këndejmi refuzohen si të pabazuara pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 e lidhur me nenin 362.1 të LPK, të cilat sipas revizionit qëndrojnë në atë se ekspertët mjekësor nuk kanë qenë të ftuar

për t'u sqaruar në gjykatë me çka është cenuar parimi i shqyrtimit të drejtpërdrejt, parimi i kundërshtimit si dhe parimi i publicitetit për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Këto pretendime janë të pabazuara për faktin se në seancën e shqyrtimit kryesor të datës më 3.12.2013, në të cilën ka qenë prezent edhe i autorizuari i të paditurës, si dhe paditësi A. S., kanë dhënë mendimet dhe konstatimet e tyre ekspertët e lartpërmendur mjekësor, lidhur me lëndimet dhe pasojat e lëndimit që paditësi Agron i ka pësuar në këtë aksident. Në mendimin dhe konstatimin e këtyre ekspertëve, nuk është dhënë vërejtje dhe propozim tjetër, nga ana e të autorizuarit të paditurës, andaj të gjitha kundërshtimet e revizionit përkitazi me mendimin dhe konstatimin e këtyre ekspertëve mjekësor, Gjykata Supreme i refuzoi si të pabazuara.

Po ashtu u vlerësuan edhe pretendimet e përgjithësuara të paditurës siç thuhet në revizionin, se lartësia e gjykuar në emër të dëmshpërblimit është e lartë dhe në kundërshtim me kriteret e kompanive të sigurimit dhe me praktikën gjyqësore. Pretendimet e tilla të revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Supreme i vlerësoi si të pabazuara, jo vetëm se në mënyrë konkrete nuk janë sqaruar arsyet pse është i lartë dëmshpërblimi i gjykuar, por edhe se me rastin e gjykimit të lartësive të lartë përmendura në emër të dëmshpërblimit kontestues, në mënyrë të drejtë është zbatuar dispozita e nenit 200 i LMD. Me rastin e gjykimit të lartësisë së këtij kompensimi për disa forma të dëmit jomaterial , gjykata në kuptim të nenit 200 par.2 të LMD, duhet të kujdeset lidhur me rëndësinë e së mirës së cenuar dhe për qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, por edhe lidhur me atë që mos të favorizohen tendencat e palës tjetër të cilat nuk janë në lidhmëni me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij. Andaj, duke marrë parasysh kriteret e parapara në këtë dispozitë juridike si dhe shkallën e zhvillimit ekonomik të Kosovës, dhe standardin jetësor të qytetarëve në Kosovë, shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë janë reale, dhe jo në kundërshtim me kriteret e lartpërmendura. Lartësia e dëmshpërblimit të gjykuar nuk është në kundërshtim me synimet shoqërore për të cilat është paraparë një formë e dëmshpërblimit të tillë , kështu që, për nga lartësia një dëmshpërblim i tillë, nuk është në kundërshtim as me kriteret e kompanive të sigurimit për zhdëmtimet në procedurë jashtë gjyqësore të personave të dëmtuar në aksidente komunikacioni, e as me praktikën gjyqësore të gjerë tanishme..

Për më tepër, Gjykata Supreme vlerëson edhe se duke marrë parasysh moshën e paditësit i cili është i lindur në vitin 1982, si dhe faktet se paditësi në këtë aksident ka pësuar lëndim të rëndë trupor, dhe për pasojë ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë me intensitet dhe kohë zgjatje të ndryshme, si dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 5%, shuma totale e kompensimit të gjykuar nga gjykatat e lartpërmendura në shumën prej 4.400,00 €, nuk tejkalon praktikën gjyqësore për dëmshpërblime të ngjashme si në rastet tjera, dhe si e tillë nuk paraqet qëllim fitim prurës për paditësin A. S.

Duke i marrë parasysh se me aktgjykim është aprovuar dëmshpërblimi në lartësinë e precizuar si në parashtrësën e të autorizuarit të paditësve, do të thotë se paditësit kanë pasur plotësisht sukses në procedurë, në kuptim të nenit 452.1 të LPK, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës, të cilat pa të drejtë në revizion kontestohen nga ana e të paditurës.

Për arsyet e paraqitura më lartë revizioni i të paditurës, në pajtim me nenin 222 të LPK, u refuzua si i pabazuar, në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.81/2017, më 21 prill 2017

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani